



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 24.2.2025

Nr: 157

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “LËVIZJA SHQIPËRIA BËHET”, ME KRYETAR Z. ADRIATIK LAPAJ, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me datë 23.1.2025, me:

**KËRKUES:** Partia politike “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, me kryetar z. Adriatik Lapaj

**OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “Lëvizja Shqipëria Bëhet” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

**BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” nëpërmjet Kryetarit, z. Adriatik Lapaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet

Data: 24.2.2025 Nr: 157  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja Shqipëria Bëhet” me Kryetar z. Adriatik Lapaj, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, datë 12.12.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, me initiale “SHB”, me Kryetar z. Adriatik Lapaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Lëvizja Shqipëria Bëhet” me shkronja nistore “SHB”, me adresë: Rruga “Jeronim De Rada”, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Adriatik Lapaj, me adresë: Rruga “Myrtezim Këllici”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Agustella Thoma, me adresë: Rruga “Stavri Themeli”, Pll. Devalb, Kt. 3, Ap. 3, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjes për komunikim me KQZ-në është Zj. Dorina Prethi, me adresë Rruga “Don Bosko”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”.

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, me kryetar z. Adriatik Lapaj, me shkronjat nistore “SHB”, si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**